ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Ankesë kundër vendimit të Komunës së Prishtinës të datës 10 nëntor 2026

Ankuesi Halit Shaljani SH.P.K., NUI 811394725

Përfaqësuesi Av. Halit Shaljani

Kontakti Rr. Nekibe Kelmendi, Objekti VG Construction, kati 1, nr. 5, 10000 Prishtinë. Tel. +383 44 142 579. Email avokatura.halitshaljani@gmail.com

Autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës së Prishtinës

Aktiviteti 616-26-7284-2-2-1 • Shërbimet e përfaqësimit, avokaturës dhe procedurave të ndërmjetësimit

Akti i kundërshtuar Vendimi i datës 10.11.2026 mbi kërkesën për rishqyrtim të datës 09.11.2026

Në emër të Halit Shaljani SH.P.K., parashtroj ankesë sipas neneve 108/A paragrafi 7, 109 dhe 111 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar (LPP). Kërkoj të anulohen pjesët e vendimit që refuzojnë ose lënë pa zgjidhje kërkesën tonë dhe të urdhërohet Komuna të korrigjojë kriteret e kualifikimit dhe të caktojë afat të ri për ofertat. Komuna ka shpallur miratim të pjesshëm, por nuk ka përcaktuar cilin pretendim e pranon, çfarë korrigjon dhe pse e mban të njëjtin afat të ofertimit. Kërkoj zbatim të menjëhershëm të efektit pezullues sipas nenit 112 të LPP-së.

1 Interesi juridik dhe afati

Shoqëria jonë ofron shërbime juridike dhe ka interes të drejtpërdrejtë të konkurrojë për kontratën. Pragu mbi shtatë vjet përvojë pas licencimit për avokatin e kërkuar, kombinimi i tij me minimumin prej pesë avokatësh dhe paqartësia për ofertimin si grup ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë tonë për të formuar ekipin dhe për të paraqitur ofertë të përgjegjshme. Interesi për shqyrtim mbetet edhe pas miratimit të pjesshëm, sepse kriteret kryesore janë mbrojtur në arsyetim dhe afati i ofertimit figuron i pandryshuar.

Njoftimi fillestar B05 u publikua më 07.09.2026. Njoftimi B54 i 09.11.2026, i dërguar më 06.11.2026, caktonte afatin e ofertimit më 16.11.2026, ora 14:00. Procedura është e hapur dhe vlera e parashikuar sipas njoftimit është 100.000 euro. Sipas kërkesës për rishqyrtim, kriteri i dhënies është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Kërkesa për rishqyrtim e 09.11.2026 u paraqit shtatë ditë kalendarike para datës së ofertimit. Me datën 16.11.2026 si ditë zero, dita e pestë prapa ishte 11.11.2026. Kërkesa u dorëzua para këtij kufiri sipas nenit 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së dhe nenit 60.1(a) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar me Rregulloren nr. 002/2024 (RRPP). Vetë Komuna konfirmoi në faqen 1 se kërkesa ishte në afat dhe kaloi në shqyrtim meritor. Kundërshtimi ynë lidhet me kriteret e dosjes që rregullonte ofertimin më 16.11.2026 dhe me zbatimin e vendimit të nxjerrë mbi kërkesën tonë.

Vendimi mban datën 10.11.2026. Nëse ankesa dorëzohet më 16.11.2026, nga data e vendimit deri në datën e ankesës kanë kaluar gjashtë ditë kalendarike (10.11 dita zero, 16.11 dita e gjashtë). Edhe sikur afati të llogaritej nga data e shënuar në vendim, dita e dhjetë do të ishte e premtja, 20.11.2026, ora 16:00.

Për afatin ligjor vlejnë nenet 5 dhe 109.2 të LPP-së dhe interpretimi i KRPP-së për datën e publikimit. Evidenca publike e E-Prokurimit e shënon vendimin më 11.11.2026, ora 09:39. Me 11.11 si ditë zero, një dorëzim më 16.11 bëhet në ditën e pestë. Dita e dhjetë bie të shtunën, më 21.11.2026, dhe afati përfundon të hënën, më 23.11.2026, ora 16:00, nëse 11.11 konfirmohet si data e parë e publikimit në

modulin përkatës. Kërkoj që OSHP të marrë nga platforma vulën e publikimit të vendimit dhe të dorëzimit të ankesës.

2 Kundërthënia në vendim dhe baza e gabuar e korrigjimit

Në faqen 5, Komuna e refuzon pretendimin nr. 5 për dëmet e likuiduara dhe e shpall pretendimin nr. 6 pjesërisht të bazuar. Në përfundimin e së njëjtës faqe, Komuna identifikon pretendimin nr. 5 si pjesërisht të bazuar. Pikat I dhe II të dispozitivit thonë se kërkesa miratohet pjesërisht dhe se do të publikohet një korrigjim, pa përcaktuar cilat pjesë të dosjes korrigjohen. Nga vendimi nuk mund të përcaktohet nëse Komuna ka pranuar të korrigjojë KVK 13.1, pasaktësitë e ngritura në pretendimin nr. 6, apo cilat prej tyre. Pretendimi nr. 7 kopjohet në faqen 4, por faqja 5 nuk jep përgjigje mbi të. Këto mangësi pengojnë zbatimin e verifikueshëm të vendimit sipas nenit 108/A paragrafët 10 dhe 11 të LPP-së dhe kontrollin e tij nga OSHP-ja.

Komuna mbështet pikat I dhe II në nenin 63.1.2 të RRPP-së, i cili rregullon miratimin kur kundërshtohet vendimi për dhënie të kontratës. Kërkesa jonë kundërshtonte njoftimin dhe dosjen. Për këtë situatë zbatohen neni 63.1.3 dhe shkronja (b) e atij paragrafi, që kërkojnë publikimin e B54 dhe zgjatjen e afatit në përputhje me nenin 53 të LPP-së. Gabimi në bazën juridike ka pasojë praktike. Njoftimi pas vendimit mban të njëjtën datë dhe orë ofertimi.

3 Pretendimet që kërkoj të shqyrtojë OSHP

Ankesa mbështetet në pretendimet nr. 1–5 dhe 7 të kërkesës së 09.11.2026. Për nr. 5 kërkoj shqyrtim për shkak të refuzimit të shprehur dhe mungesës së një korrigjimi të identifikueshëm. Pretendimi nr. 6 përmendet për të sqaruar kundërthënien në vendim. Pjesën e miratuar nuk e kundërshtoj.

3.1 Pragu mbi shtatë vjet pas licencimit

Komuna i përgjigjet bashkërisht pretendimeve nr. 1 dhe 2 me referim në llojin, numrin dhe kompleksitetin e lëndëve. Nuk identifikon çfarë lënde ose detyre kërkon pragun konkret, çfarë niveli përvoje duhet për atë detyrë dhe si është përcaktuar se më shumë se shtatë vjet pas licencimit janë të domosdoshme. Sipas neneve 7, 51.3 dhe 69 të LPP-së, kriteri duhet të lidhet me objektin dhe të jetë proporcional me nevojën e kontratës.

Sipas neneve 4.1.4 dhe 6.1 të Ligjit nr. 04/L-193 për Avokatinë, përfaqësimi para gjykatave hyn në fushën e avokatisë dhe e drejta për ushtrimin e profesionit fitohet me regjistrim në regjistrin e Odës. Avokati mund të përfaqësojë palë para gjykatës nga fitimi i së drejtës për ushtrim, sipas rregullave procedurale të rastit. Komuna e ka lidhur pragun me përvojën e operatorit, ndërsa kushti kërkon që një person i vetëm të ketë mbi shtatë vjet përvojë pas licencimit. Përgjigjja nuk shpjegon pse cilësia e ekipit dhe referencat për raste të krahasueshme nuk mjaftojnë. Një avokat me gjashtë vjet praktikë intensive në konteste të ngjashme nuk e plotëson kushtin. Një avokat me mbi shtatë vjet përvojë pas licencimit mund ta plotësojë edhe kur përvoja e tij është në një fushë tjetër. Kërkojmë të matet përvoja me çështjet konkrete që avokati ka trajtuar dhe me detyrën që do të kryejë në kontratë. Kërkoj që OSHP të marrë vlerësimin paraprak të njësisë kërkuese dhe, nëse pragu mbetet i paarsyetuar, të urdhërojë zëvendësimin e tij me licencë aktive dhe përvojë relevante të dëshmueshme.

3.2 Vjetërsia e shoqërisë dhe pjesëmarrja si grup

Pohimi se grupet e operatorëve lejohen nuk sqaron nëse FDT 9.1 dhe 9.2 ende kërkojnë shoqëri avokatësh me më shumë se tri vjet ekzistencë, si bashkërendohet ky kusht me FDT 11.1 dhe nëse zyrat individuale mund të konkurrojnë bashkë. Vjetërsia e regjistrimit nuk demonstron vetvetiu aftësi për zbatimin e kontratës. Kërkoj heqjen e kushtit nëse është mbajtur dhe vlerësimin e aftësisë mbi licencat, përvojën e dëshmuar dhe personelin e disponueshëm.

Nenet 66 dhe 71 të LPP-së dhe neni 2 i Ligjit për Avokatinë mbështesin verifikimin e të drejtës profesionale dhe ofertimin nga një grup i operatorëve të ligjshëm. Sipas nenit 71.1, për dorëzimin e tenderit grupit nuk mund t'i imponohet formë e veçantë juridike. Kërkoj që dosja të lejojë qartë ofertimin e përbashkët të avokatëve ose zyrave individuale pa themelim paraprak të një shoqërie të avokatëve. Licencat verifikohen sipas rolit të secilit, ndërsa kapacitetet e bashkueshme vlerësohen për grupin si tërësi. Nëse Komuna kërkon të provojmë se personeli i deklaruar do të jetë realisht në dispozicion, këtë mund ta verifikojë me marrëveshjen e grupit dhe zotimet e avokatëve të angazhuar, siç lejon neni 69.8 i LPP-së.

3.3 Qarkullimi dhe kontratat e ngjashme

Komuna sqaron se 200.000 euro i referohen qarkullimit të OE ose grupit në tri vitet e fundit, kurse 150.000 euro kontratave të ngjashme të realizuara në tri vitet para publikimit të njoftimit. Ky sqarim dallon natyrën e dy kritereve. Mbetet të përcaktohet në FDT 8.1–8.2 dhe 9.1–9.2 nëse pragu i qarkullimit është shumë kumulative, mesatare ose kërkesë për secilin vit, cilat vite financiare llogariten dhe cilat prova pranohen. Referimi i përgjithshëm në Udhëzuesin për Prokurimin Publik nuk shpjegon proporcionalitetin e pragut për kontratat e ngjashme në raport me shërbimet që prokurohen dhe vlerën e parashikuar prej 100.000 eurosh. Kërkoj harmonizimin e dokumenteve dhe verifikimin e bazës së secilit prag sipas neneve 7, 27, 51.3, 68 dhe 69 të LPP-së.

3.4 Minimumi prej pesë avokatësh

Komuna e quan minimumin të domosdoshëm dhe i referohet një vlerësimi paraprak të ngarkesës. Vendimi nuk paraqet numrin e rasteve të pritshme që zhvillohen njëkohësisht, shpërndarjen e tyre dhe profilin e kërkuar për secilin anëtar të ekipit. Kërkoj që OSHP të verifikojë vlerësimin e njësisë kërkuese, të urdhërojë uljen e minimumit kur dokumentet nuk e arsyetojnë atë dhe të kërkojë qartësim të provave për angazhimin me marrëveshje dhe për disponueshmërinë e stafit të grupit, sipas neneve 7, 51.3, 69 dhe 71 të LPP-së.

3.5 Dëmet e likuiduara

KVK 13.1, sipas versionit të kundërshtuar, parashihte 0,25% në ditë mbi çmimin final të tërë kontratës dhe tavan prej 10% të atij çmimi. Cilësimi i klauzolës si standarde nuk zgjidh bazën e llogaritjes. Për kontratën kornizë, kërkoj shqyrtimin e KVK 13.1 sipas nenit 71A.1(e) të RRPP-së, që përcakton rregullin për porosinë përkatëse. Nëse klauzola është mbajtur, kërkoj që të përcaktohen shprehimisht rrethanat e zbatimit, vlera e shërbimeve të parealizuara si bazë ditore dhe tavani i lidhur me vlerën e porosisë, sipas rastit që rregullon dispozita. Një bazë e pasaktë e penalitetit ndikon në çmimin dhe riskun që ofertuesi merr përsipër.

3.6 Afati i ofertimit sipas pretendimit nr 7

Kërkesa e 09.11.2026 ngriti dallimin ndërmjet ndryshimit të dosjes më 06.11.2026, ora 15:40, dhe publikimit të B54 më 09.11.2026. Komuna nuk tregoi kur operatorët patën qasje në informacionin e plotë. Nëse informacioni përkatës u dha më 09.11.2026, afati i 16.11.2026 siguronte vetëm shtatë ditë kalendarike. Kur plotësohen kushtet e nenit 53.7 të LPP-së, operatorëve duhet t'u jepen së paku dhjetë ditë nga dhënia e informatave përkatëse.

Pas vendimit, faqja publike shënon «Dosja e Tenderit 11.11.2026.Docx» me ndryshimin e fundit më 11.11.2026, ora 13:51. B54 nr. B54-0025314 u dërgua më 11.11.2026 dhe u publikua më 12.11.2026. Ai ruan afatin e 16.11.2026, ora 14:00. Edhe nëse operatorëve u janë vënë në dispozicion ndryshimet më 11.11.2026, periudha deri në afatin e ofertimit ishte pesë ditë kalendarike. Ky njoftim është provë e mënyrës së zbatimit të vendimit dhe e pretendimit nr. 7 të ngritur në kërkesën paraprake. Nëse ndryshimet materiale i 'u komunikuan operatorëve më 12.11.2026, deri më 16.11.2026 kishin vetëm

katër ditë kalendarike. Kërkoj të sigurohen versionet para dhe pas korrigjimit dhe gjurma e komunikimit në E-Prokurim, si dhe të zbatohet neni 63.1.3(b) i RRPP-së në lidhje me nenin 53 të LPP-së.

4 Kërkesat drejtuar panelit shqyrtues

Sipas neneve 105.2.3 dhe 105.2.5 të LPP-së, kërkoj marrjen dhe verifikimin e dosjeve në fuqi më 09.11.2026 dhe pas korrigjimit, arsyetimin e njësisë kërkuese për pragjet e kualifikimit dhe regjistrin elektronik të komunikimit. Sipas neneve 113.1 dhe 114.1, kërkoj që eksperti shqyrtues t'i vlerësojë individualisht pretendimet e kësaj ankese. Sipas neneve 105.2.7, 105.2.8, 105.2.10, 105.2.11 dhe 117.1 të LPP-së, kërkoj që paneli të vendosë me arsyetim dhe të urdhërojë masat e mëposhtme.

- Të konstatojë pranueshmërinë e ankesës dhe të sigurojë zbatimin e efektit pezullues sipas nenit 112 të LPP-së, duke e njoftuar menjëherë Komunën për shkak të afatit të ofertimit.
- Të aprovojë ankesën për pretendimet e bazuara dhe të anulojë vendimin e 10.11.2026 në pjesët e kundërshtuara, duke përcaktuar saktë korrigjimet që Komuna duhet t'i zbatojë.
- Të urdhërojë që pragu mbi shtatë vjet të zëvendësohet me licencë aktive dhe dëshmi të përvojës së krahasueshme, nëse dokumentacioni i njësisë kërkuese nuk provon nevojën për pragun aktual. Të rishikohet minimumi prej pesë avokatësh sipas ngarkesës së dokumentuar.
- Të hiqet kushti i vjetërsisë mbi tri vjet, nëse figuron ende në dosje, dhe të përcaktohet shprehimisht se avokatët ose zyrat individuale mund të ofertojnë si grup. Të harmonizohen kriteret financiare e të përvojës. Për KVK 13.1, të verifikohet nëse është korrigjuar dhe të urdhërohet harmonizimi me nenin 71A.1(e) nëse klauzola vazhdon të llogarisë penalitetin mbi tërë kontratën kornizë.
- Të urdhërojë publikimin e një B54 me dosjen e harmonizuar dhe caktimin e një afati të ri për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, të llogaritur nga komunikimi efektiv i ndryshimeve. Nëse ofertat tashmë janë hapur, të urdhërojë masën korrigjuese që mundëson konkurrim të barabartë mbi dokumentacionin e korrigjuar.
- Në subsidiaritet, të kthejë çështjen në rishqyrtim me detyrimin për vendim të arsyetuar për secilin pretendim dhe për zbatim të korrigjimeve përpara vazhdimit të aktivitetit. Në rast aprovimi, të urdhërojë kthimin e tarifës së ankimit sipas nenit 118 të LPP-së dhe nenit 69.5 të RRPP-së.

Ankesa synon korrigjimin e kushteve të konkurrimit. Shoqëria nuk parashtron kërkesë për kompensim monetar.

5 Provat dhe bashkëngjitjet

- Kërkesa për rishqyrtim e 09.11.2026 dhe konfirmimi elektronik i dorëzimit.
- Vendimi i Komunës i 10.11.2026, pesë faqe, dhe evidenca e E-Prokurimit që e shënon dokumentin më 11.11.2026, ora 09:39.
- B05-0019091 i 07.09.2026, B54-0024904 i 09.11.2026 dhe B54-0025314 i 12.11.2026, me versionet përkatëse të dosjes, FDT-së, KVK-së dhe çmimores.
- Dëshmia e pagesës së tarifës prej 1.000 eurosh sipas nenit 118 të LPP-së dhe nenit 69.2(b) të RRPP-së, llogaritur mbi vlerën e parashikuar prej 100.000 eurosh.
- Certifikata e regjistrimit dhe dëshmia e përfaqësimit të shoqërisë, sipas rastit.

Kërkoj që OSHP t'ia kërkojë Komunës dokumentet e vlerësimit paraprak të njësisë kërkuese dhe regjistrin e publikimeve e të komunikimeve të aktivitetit në E-Prokurim.

Vendi dhe data Prishtinë, 16.11.2026

Për ankuesin Av. Halit Shaljani, Halit Shaljani SH.P.K.

Nënshkrimi dhe vula

